

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025” të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

Titulli i Projekt-aktit : “Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025”

Grupet që u konsultuan: Banorët e të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime : 170 persona, nga të cilët 41 gra dhe vajza (24%)

Numri i rekomandimeve: 101

Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimet publike janë mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës së shkollave,
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale,
- Përmirësimin e shërbimeve publike ujësjellës kanalizime,
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik
- Pastrimi i kanaleve vaditëse dhe rendeve të ujit
- Shtimi i hapësirave rekreative për të rinjtë

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web dhe facebook të Këshillit Bashkiak.

Pas konsultimeve me banorët dhe grupet e ndryshme të interesit janë ndryshuar disa nga datat e dhe numri i takimeve të realizuara me qëllim pjesëmarrjen sa më të madhe të qytetarëve në këtë proces.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Iballe, më 18. 11. 2024

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE "PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMEËM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025" NË NJËSINË ADMINISTRATIVE IBALLE

I mbajtur sot, më 18. 11. 2024.

Vendi: Në ambientet e Njesisë Administrative Iballe

Ora:13:00

TEMA: DËGJESË PUBLIKE "PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMEËM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025".

Në takim morën pjesë nga **NJVQV:**

Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri;**
Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Mikel Qafa;**
Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Kola;**
Kordinatori i projekteve me BE, **z. Elis Miria**
Specialiste IT, znj. **Albina Prenga**
Sekretar i Këshillit Bashkiak, **znj. Naze Selimaj**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjesë publike janë **banorët e Njesisë Administrative Iballe, (Iballe; Lëvoshë; Sapaç; Mërtur; Berishë e Sipërme; Berishë e vogë; Shopel; Berishë Vendi) si dhe kryetarë të fshatrave.**

Fjalën hapëse e mban Administratori i Njesisë Administrative **z. Akil Zmalaj:**

Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, **z. Hil Curri** për dëgjesën publike të organizuar.

Kjo dëgjesë është shumë e rëndësishme për konstatimin e prioriteteve dhe pasqyrimin e nevojave që kanë banorët e Njesisë Administrative Iballe në buxhetin e vitit 2025.

Ne jemi përpjekur shumë për më shumë se një vit t'ju ofrojmë shërbime banorëve të Njesisë tonë Administrative dhe këtu gjej rastin të falenderoj punonjësit e Administratës që kanë qenë në gatishmëri çdo ditë në shërbim të banorëve.

Do të fokusohemi tek investimet në infrastrukturë si dhe në bujqësi e blegtori.

Investimet në bujqësi e blegtori janë investime të domosdoshme për zonën tonë.

Zona jonë ka shumë resurse dhe mund t'a administrosh shumë mirë.

Këtu ka shumë problematika të trashëguara që nga qëverisja e mëparshme vendore si rrugët rurale, kanalet vadiëse, ujësjellësat.

Kërkojmë punonjës për mirëmbajtjen e ujësjellës kanalizimeve i cili të jetë zanatli në këtë fushë.

Iballja po vuan në furnizimin me ujë të pishëm për faktin se tubacionet që e transportojnë atë janë tejet të amortizuar.

Kërkojmë ndërhyrje në pusetat e shpërndarjes së ujit të pishëm sepse ato janë në kushte të mjerueshme.

Kërkojmë të përmirësohen kushtet në shkollat.

Unë ftoj këshilltarët si dhe çdonjërin prej jush të ngremë zërin për nevojat që ka komuniteti sot në këtë dëgjesë publike në mënyrë që të mblidhen prioritetet dhe ato të përkthehen në buxhetin e vitit 2025.

Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri:**

Unë ju falenderoj për pjesëmarrjen të gjithëve, falenderoj gjithashtu dy Këshilltaret e Bashkië Fushë-Arrëz, të cilat janë treguar bashkëpunuese dhe kanë lobuar herë pas here për për plotësimin e nevojave të zonës së tyre. Zonjat Këshilltare janë të rregullta me pjesëmarrjen e tyre në çdo mbledhje Këshilli, kështu që ju banorëve të Njesisë tuaj nuk ju ka shkuar vota dëm. Falenderoj dy Zv/Kryetarët, sekretaren e Këshillit Bashkiak.

Ne jemi përpjekur me të gjitha mundësitë dhe kapacitetet tona t'ju shërejmë banorëve në të gjitha Njësitë Administrative. Jemi koshient se Njësia Administrative Iballe ka problematika të mëdha dhe nevoja emergjente për ndërhyrje. Administratori juaj ka ngrit herë as here problemikat që ka Njësia Iballe.

Kjo nuk na bën pesimist vetëm na bën më të fortë për të shkuar përpara përmes punës e shërbimeve.

Rrugët që lidhin fshatrat e Njesisë Iballe janë afërsisht 60-70 km dhe këto mirëmbahen.

Ne kemi pak punonjës të mirëmbajtjes, 15 punonjës i mbulojmë me fondet e Bashkisë dhe 15 të tjerë i mbulojmë me fonde të deleguara. Administratori i Njesisë Administrative Iballe dhe dy zonjat Këshilltare kanë sjellë problemikat dhe ne jemi përpjekur për secilin rast të gjejmë zgjidhje dhe të oftojmë shërbime.

Unë e kam detyrë të punësoj të rinjtë në mënyrë që të mos largohen nga vendlindja. Pavarësisht kësaj nuk kam pasur mundësi t'i punësoj të gjithë deri tani por as kurre nuk heq dorë nga realizimi i objektivit për punësimin e të rinjve.

Pjesa dërrmuese e problematikave janë të trashëguara të cilave do t'ju japim zgjidhje.

Sa i përket shkollave edhe sikur një fëmijë të mbetet ne do bëjmë të mundur ofrimin e kushteve e mundësive për shkollim sit të ishim 100 fëmijë. Ne do të rritim standartet e shërbimit për të jetuar si qytetarë të BE.

Kemi filluar punimet për ndërhyrje në rezervuarin e Iballes sepse është domosdoshmëri për vaditje.

Rrugët janë të ndërtuara pa kritere dhe me pjerrësi shumë të madhe e megjithatë jemi përpjekur të bëjmë mirëmbajtjen e tyre.

Këshilli Bashkiak ka bërë një shpërndarje proporcionale në të gjitha Njësitë Administrative në mënyrë të brabartë respektivisht me nga 40 milion lekë të vjetra për secilën Njësi.

Punësimi ka qenë një ndër prioritetet e mia për zhvillimin e zonës. Unë s'kam lënë derë pa trokitur në kërkim të shtimit të mundësive për shërbime ndaj komunitetit. Nëse unë nuk e kaloj 50% të realizimit të objektivave, nuk e kërkoj më votën tuaj, besoj nuk do t'ju zhgënjej.

Ndërhyrjet në ujësjellësa janë të domosdoshme por tashmë dihet se kjo ndërmarrje i ka kaluar qarkut Shkodër dhe ne si Bashki nuk na lejohet të ndërhyjmë.

Unë nxit emigrantët dhe bizneset të kthehen e të invetojnë në vendin e tyre.

Kam lobuar për ndërtimin e rrugës që bashkon Iballen me Fierzën.

Me Ambasadën Japoneze kemi firmosur për blerjen e një mjeti të ri i cili do të shërbejë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe për shërbime të tjera. Kemi bërë planin e menaxhimit për vendosjen e paneleve diellore për prodhimin e energjisë elektrike, ku njëri nga plantacionet do të jetë në Iballë. Një ditë pushim nuk e kemi bërë duke studiuar rrugët e pyjet për shërbime e investime. Nuk po neglizhojmë asgjë, thjesht na duhet koha e nevojshme.

Ju falenderoj për kohën dhe pritjen, dëgjuesat pubike janë detyrim ligjor për ndërtimin e buxhetit me përparësi prioritetet e banorëve, jemi të hapur të presim rekomandimet tuaja.

Sokol Sokolaj, Kryetar i fshatit Lëvoshë:

Iballja është Njësia më e largët Administrative. Brenda mundësive ne këtkojmë:

- **Të riparohen rrugët që lidhin 5 fshatrat e Iballes;**
- **Të ndërtohet urë me kalu materialet;**
- **Rruga për me shku te shkolla shumë e vështirë dhe larg, të ndërhyhet;**
- **Të pastrohen rrugët deri në Shopel;**
- **Të na mundësoni 300 m tub për rregullimin e kanalit vaditës sepse ka një vend të vështirë që na humbet uji kur vadisim në verë;**
- **Kërkojmë furnizim të pandërprerë me energji elektrike.**

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri**:

Faleminderit që ngrite problematikat, ne do përpiqemi t'i realizojmë me çdo çmim.

Kryetari I fshatit Berishë e vogël:

- **Të ndërhyhet për riparimin e rrugës së Pabit në fshat, nuk kalohet me makinë, 2 mure anash e mundësojnë këtë ;**
- **Të ndërhyhet për riparimin e rrugës këmbësore prej katundit të Kishës e deri në Zvinë.**

Kryetari i Bashkisë, z. Hil Curri:

Muri mbajtës do të mundësohet;

Rruga këmbësore do t'a bëjmë;

Në të gjitha vijat vaditëse do të ndërhyjmë në të gjithë Bashkinë;

Kemi bërë por realitet është se kemi gjetë shumë punë të pabëra ndër vite, kjo nuk na bën pesimist, do punojmë pareshtur deri në plotësimin e nevojave të komunitetit.

Gëzim Dema, Drejtor i shkollës Iballe:

Ju falenderoj për gatishmërinë dhe mbështetjen që na keni dhënë në çdo herë!

Kemi një kërkesë:

Të ndërtohet ose të përshtatet një ndërtesë si qendër multifunksionale në shërbim të komunitetit, është një object në qenër, I cili mund të përshtatet.

Kryetari i Bahkisë, z. Hil Curri:

Të falenderoj drejtor për idenë. Një qendër e tillë do të ishte mundësi shumë e mirë sidomos për të moshuarit. Do e shikojmë me përparësi.

Kristian Shahini, banorë:

Jemi në terr, kërkojmë energji elektike, kjo është shumë problematike.

Ndoc Pemati, banorë:

- **Kërkojmë dërrasa për ndërtimin e urës e cila ka rrëshqit dhe është bërë copë copë, dërrasat janë kalbur.**
- **Kërkojmë nga ju ndërhyrje në ujësjellës, ka rrjedhje, s'kemi ujë për dimër, ju lutemi na e mundësoni.**

Kryetari i Bahkisë, z. Hil Curri:

Ujësjellësin e ka Shkodra, ne do e delegojmë këtë nevojë njëkohësisht edhe vetë do bëjmë ç'të mundemi. Edhe te ura do bëjmë diçka.

Pëllumb Vata, banorë:

Kërkojmë investim aty ku nuk është investuar;

Ujësjellësi do duhej të ishte mbyll tash 5 vjet, ju lutem ngrini zërin në instancat e duhura për stabilizimin e ujit të pishëm, tubat janë amortizuar;

Janë të hapura pusetat e ujit të pishëm, jashtë çdo kushti e rregulli;

Urat me pak investime rregullohen;

Vijat e ujit nuk janë pastruar 2 vjet, zakonisht pastrohen nga rentarët por tani kanë mbetur pak persona dhe kështu është bërë e vështirë nga ana e rentarëve;

Duhet Bjellorus për hapjen e rrugës;

Administratori I Iballes ka punu për rrethimin e pusit ku kalojnë fëmijët, ka punu për hapjen e vijave, janë bërë punime, ka nevojë për më tepër;

Kërkojmë shërbimin nga Bashkia për mirëmbajtje të vijave vaditëse dhe ne të paguajmë për shërbimin.

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri:**

*Vijat e zakonit ekzistuese do i vemë të gjitha në punë;

*Kemi bërë rezervuarin e Iballes dhe do bëjmë transport me tuba nëse është e mundur;

*Do japim ndihmesën tonë për të hapur vijat vaditëse.

Pashk Hasani, Kryetar i fshatit Mertur:

Ne si fshat kemi disa problematika:

- **Ujësjiellësi është i dëmtuar, janë me tub ajsbest;**
- **Pusetat e ujit të pishëm të hapura, jashtë kushteve normale;**
- **Të zëvendësohen tubat e ujit të pishëm;**
- **Rrugët në nevojë riparimi;**
- **Ura që lidh Berishën me Merturin nuk funksionon;**
- **Rruga e Merturit ka nevojë për punëtor mirëmbajtje;**

Ju falenderojmë për kontenierët që janë improvizuar për shkollë,

duhet të vendosen të shkolla ekzistuese, jo në tokë private.

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri:**

* Për rrugën këmbësore do të ofrojmë shërbime dhe nuk do të ketë bllokime;

* Merturi ka nevojë për një punonjës të mirëmbajtjes së rrugëve, do e bëjmë të mundur.

Rifat Mani, banorë i Njësisë Iballe:

Jemi të shqetësuar për lumin e ndotur nga ujërat e zeza, kërkojmë ndërhyrjen tuaj;

Kërkojmë kosha për mbeturinat te cilat kanë mbushur përroin.

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri:**

- Në fshatra askush nuk ka të drejtë të lerë ujërat e zeza të derdhen në përrua, bëhen gropa;
- Koshat e mbeturinave do vendosen në mes të lagjes.
- Do të lidhim lagjet me ndriçim.

Astrit Aga, banor:

Kërkon rrethimin e varrezave.

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri**:

Rrethimi I varrezave do të bëhet edhe pikë, nuk ka diskutim.

Detmir, banor

- **Kërkojmë mirëmbajtjen e rrugës Iballe-Berishë, punëtor mirëmbajtje;**
- **Rruga e Merturit ka nevojë për punëtor mirëmbajtje;**
- **Rruga Iballe-Trame ka nevojë për punëtor mirëmbajtje;**
- **Të pastrohet rruga që na lidh me Tropojën.**

Kryetari i Bahkisë, **z. Hil Curri**:

Ishte kënaqësi, do takohemi përsëri, jam i hapur ndaj çdonjërit!

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Fushë-Arrëz, më 14. 11. 2024

**PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE NË FUSHË-ARRËZ, QYTET
”PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, BUXHETI I
BASHKISË PËR
VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025”**

I mbajtur sot, më 14. 11. 2024.

Vendi: Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Ora: 11:00

TEMA: DËGJESË PUBLIKE ”PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025” NË FUSHË-ARRËZ, QYTET ME BANORË DHE DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE NË QENDËR DHE PËRFAQËSUES NGA SHOQËRIA CIVILE DHE BIZNESI.

Në takim morën pjesë nga NJVQV:

Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri**;

Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Mikel Qafa**; Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Hil**

Kola;

Kordinatori i Projekteve me BE, **z. Elis Miria**;

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Nikolin Bardhoku**;

Përgjegjësi i Sektorit të Financës, **z. Dritan Lika**;

Sekretar i Këshillit Bashkiak, **znj. Naze Selimaj**.

Të pranishëm në këtë dëgjese publike janë **banorët e qytetit Fushë-Arrëz si dhe të fshatrave Fushë-Arrëz, Micoj dhe Lumardh të kryesuar nga kryetarët respektivë, Lekë Curri, Jetmir Sylja dhe Mark Gega. Në takim janë të pranishëm drejtuesit e institucioneve dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe biznesi.**

Fjalën hapëse e mban Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri**:

Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjese konsultative ku pjesëmarrja juaj tregon se interesi qytetar dhe padyshim besimi ndaj pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Dëgjesat publike si kjo janë të rëndësishme për një qeverisje pranë qytetarëve. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë çdo

kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime publike në mënyrë që të ndërtojmë një buxhet sa më afër realitetit.

Realisht jemi përball një realiteti i cili kërkon investime të mëdha, përpos kësaj jam optimist se do të kemi arritje të kënaqshme. Padyshim që çdo kërkesë e juaja është marrë parasysh dhe është pasqyruar me investimet e vitit që po lëmë pas.

Banorët kanë pritshmëri të mëdha dhe ju e dini që unë kam bërë përpjekje maksimale dhe do të vazhdoj t'a bëj për me gjetë çdo lloj mundësie për t'iu ardhur në ndihmë banorëve të zones si për realizimin e nevojave që janë kompetencë e bashkisë, ashtu edhe për nevojat që nuk janë kompetencë e bashkisë, besoj fortësisht se nuk do t'ju zhgënjëj.

Klima e investimeve është shumë e mirë dhe në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave do t'ia dalim.

Kemi lobuar me Ambasadën Japoneze e cila na ka premtuar për një mjet të ri për kryerjen e punimeve, nesër firmosim kontratën. Ne do të llojmë për kryerjen e investimeve në mënyrë që të mbajmë këtu banorët dhe gjithashtu për kthimin e banorëve duke ju krijuar kushte normale të jetesës përmes punësimeve dhe shërbimeve të ofruara nga bashkia.

Në qytet kemi riparuar disa pallate dhe jemi në process për riparimin e disa të tjerëve.

Kopshti i fëmijëve ka qenë në gjendje të mjerueshme dhe ka filluar rikonstruksioni.

Kemi identifikuar problematikat dhe kemi hartuar projekte që financohen nga vetë bashkia.

Është realizuar furnizimi me ujë të pishëm.

Kemi vënë Panele Diellore përmes të cilave është realizuar ndriçimi për dy lagje të fshatit Fushë-Arrëz.

Të gjithë banorët duhet të dinë zërat e shpërndarjes së buxhetit dhe ne jemi transparent për këtë duke jua vënë në dispozicion këtë në faqen eeb të bashkisë dhe në rrjetet sociale përkatëse. Do jemi të gjithë bashkë në dijeni për shpërndarjen e buxhetit në të gjitha Njësitë dhe zonat e Bashkisë. Shpërndarja e fondeve për shërbime në të gjitha fshatrat do të bëhet në mënyrë proporcionale, të drejtë dhe të barabartë.

Kemi disa shembuj pozitiv ku individë të veçantë kanë ndërmarrë iniciativa për financime personale në shërbim të komunitetit në Buxhon dhe në Fierzë dhe ne i kemi mbështetur dhe do i mbështesim fort.

Kam 12 muaj që lloboj për hapjen e një banke në qytetin Fushë-Arrëz dhe besoj që shumë shpejt do të jetë në shërbim të të gjithë banorëve të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Administratorët e pallateve janë domosdoshmëri, do të zgjidhen edhe aty ku nuk janë.

Gjej rastin të falenderoj Kryetarin e Këshillit Dr.Nikolin Bardhoku dhe Përfaqësuesin e Këshillit tonë Bashkiak, Franc Doda në Këshillin e Qarkut Shkodër për bashkëpunimin dhe ndërlidhjen me Qarkun ku si rezultat është bërë e mundur lidhja e rrugës nga Kisha deri tek shtëpia e Shefqet Sadria.

Buxheti i vitit 2025 është thuajse sa ai i vitit të kaluar por besoj do t'ia dalim edhe me ndihmën e donatorëve të huaj.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, Dr.Nikolin Bardhoku:**

Përsëritet të gjithë pjesëmarrësve dhe falenderime për praninë në këtë dëgjese publike.

Jemi në fazën e dëgjësive publike të cilat janë mekanizëm ligjor për mbledhjen e nevojave dhe rekomandimeve të banorëve në mënyrë që të pasqyrohen në kohë në buxhetin e vitit 2025

Bashkia harton plane vjetore afatmesme dhe afatgjata. Duhet që të gjitha zyrat të përpilojnë kërkesat dhe rekomandimet e dala nga Dëgjësat Publike deri në afatin e përcaktuar.

Ftoj të gjithë të bëjnë propozimet dhe rekomandimet në kohën e duhur në mënyrë që të reflektohen në buxhet deri në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku edhe do të miratohet ky buxhet.

Parimisht dhe realisht buxheti duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë për të gjitha Njësitë Administrative që janë në juridiksionin e bashkisë Fushë-Arrëz.

Dua të sjell në vëmendje efikasitetin nëpërmjet rritjes së performancës nga ana e punonjësve të Administratës së Bashkisë.

Këshilli Bashkiak miraton pagat e të gjithë punonjësve të administratës së bashkisë.

Këshilli Bashkiak nëse ve në dukje se nuk janë efikas vendet e punës e shkurton atë vend pune. Është detyrim ligjor i secilit punonjës të bashkisë të zbatojë rregulloren.

Jemi në fazën e projekteve me bazë bashkëpunimin rajonal. Këto projekte mund t'i bëjnë zyrat duke shkëmbyer përvojat me të tjerët.

Franci ka bërë lobime në qark dhe shpresojmë për më shumë burime që plotësojnë buxhetin.

Së fundi ju falenderoj duke ju uruar suksese dhe mbarësi të gjithëve.

Pashk Prendi, banorë në qytetin Fushë-Arrëz:

Përsëritet të gjithë të pranishmit dhe vë theksin në rrugën që del nga Kisha deri te varrezat e fshatit, sa herë bie shi, mbushet kanali dhe sjell inerte.

Kërkojmë të "disiplinohet" uji përmes kanaleve anësore në mënyrë që të mirëmbahet rruga.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **Dr. Nikolin Bardhoku**:

Kjo rrugë për të cilën po flet Pashku duhet të rregullohet sepse nuk dilet me mjete të zakonshme.

Më tej fjalën e merr Përgjegjësi i Sektorit të Financës **z.Dritan Lika**:

Mbasi përsëritet të pranishmit dhe i falenderon për praninë në këtë konsultë publike, prezanton Projektbuxhetin për vitin 2025:

MISIONI I BASHKISË

Fushë-Arrëzi, si një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve rajonale në veri të Shqipërisë, një zonë e ripërtërirë ekonomikisht, që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

Të dhëna mbi Bashkinë:

- Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës-Prishtinë dhe gjendet në pjesën verilindore të Shqipërisë.
- Bashkia Fushë-Arrëz përbëhet nga katër Njësi Administrative dhe Bashkia Qendër dhe numëron 11 498 banorë ose 3791 familje.
- Qyteti i Fushë-Arrëzit njihet si qendër e vogël industriale ku ka mbizotëruar për vite me radhë industria e përpunimit të drurit dhe ajo e

pasurimit të bakrit. Mbyllja e tyre u shoqërua me një gjendje të vështirë ekonomike dhe me një rritje të papunësisë.

Të ardhurat:

Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2025 do të vijnë nga:

1. Taksat dhe Taritat Vendore të cilat janë programuar në përputhje me Paketën fiskale;
2. Transferte e pakushtëzuar;
3. Transferta specifike;
4. Grant i trashëguar nga viti 2024 (Rishikim buxheti Janar 2025);
5. Të ardhura të trashëguara nga viti 2024(Rishikim buxheti Janar 2025).

Të dhëna mbi buxhetin:

Politikat e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 kanë synuar:

1. Mbështetjen financiare të kërkesave të komunitetit;
2. Zgjerimin e biznesit në Bashki, pavarësisht potencialit ekonomik të Bashkisë;
3. Investime të shoqëruar me politika specifike në favor të grupeve të ndryshme;
4. Uljen e papunësisë;
5. Rritjen ekonomike etj.

Jepet informacion edhe përmes tabelës së hyrjeve.

Përgjegjësi i Sektorit të Financës **z.Dritan Lika**, grafikisht paraqet:

- TË ARDHURAT NË BUXHETIN E VITIT 2025;
- RAPORTI TRANSFERTË SPECIFIKE / TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR
- TRANSFERTA PËR BANORË:

Nr.	Emërtimi	2024	2025
1	Transferte e pakushtëzuar	103 802 000	108 997 000
2	Transferte e pakushtëzuar / banorë	9 028	9 480

- GRAFIKU I TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR 2024-2025;
- GRAFIKU I TRANSFERTËS PËR NUMËR BANORËSH;
- TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE;

- GRAFIKU I TË ARDHURAVE TË VETA PËR VITIN 2025 (TAKSA DHE TARIFA);
- SHPENZIMET:
 Aktiviteti ekonomik i Bashkisë është i lidhur ngushtësisht me shpenzimet për:
 1. Paga dhe Sigurime shoqërore.
 2. Shpenzime operative dhe mirëmbajtje, pa të cilat Bashkia nuk do të mund të përmbushë asnjë prej detyrimeve të veta.
 3. Investime kapitale.
 4. Transferta (Këshilli i qarkut, Fondi rezervë, Emergjencia dhe Kontigjenca etj).
- FUNKSIONET SPECIFIKE:
 Përveç funksioneve bazë, Bashkia ka edhe funksionet specifike si më poshtë:
 1. Arsimi parashkollorë dhe ai i mesëm;
 2. Rugët rurale;
 3. Administrimi i pyjeve;
 4. Mbrojtja nga zjarri;
 5. Ujitja dhe kullimet.
- BUXHETI I FINANCUAR NGA QEVERISJA QENDRORE.

Në fund Përgjegjësi i Sektorit të Financës falenderon edhe njëherë të pranishmit për vëmendjen dhe tregon gatishmërinë për t'ju përgjigjë pyetjeve nëse ka.

Kryetari i Bashkisë, z.Hil Curri:

Dritani i trajtoi me shifra, dua të them që për biznesin e madh jemi përpjekë të mos

e rrisim taksën.Ndërsa e kemi rritur pak taksën e pastrim-gjelbërimit për fabrikën gjë e cila rrit sadopak të ardhurat.

Problematikë janë borgjet të cilat e trondisin buxhetin por asnjëherë nuk jam pesimist, thjesht ulim vlerën e investimeve në përputhje me ligjin.

Për një gjë ju siguroj që në një formë apo ndonjë tjetër të gjithë qytetarët do marrin shërbimin e duhur.

Hil Kola, Zv/ Kryetar i Bashkisë Fushë-Arëz:

Përsëritje të gjithë pjesëmarrësve dhe falenderime për praninë në këtë dëgjese publike.

Kemi një vlerë të buxhetit për vitin 2025 të përafërt me atë të vitit të kaluar. Përmes buxhetit të vitit 2024 kemi riparuar problematikat kryesore. Vendimet gjyqësore të mbartura nga Qeverisja Vendore e mëparshme kanë dëmtuar rëndë buxhetin. Ne jemi të detyruar t'i zbatojmë vendimet e gjykatës.

Duhet të shohim me përparësi zonat rurale të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje.

Mundësitë janë të vogla, pavarësisht rritjes së disa taksave që janë minimale.

Paralel me shërbimet që ofron bashkia, kërkojmë edhe ndërgjegjësimin e banorëve të paguajnë taksat. Ne si Bashki jemi të gatshëm në çdo moment për shërbime ndaj komunitetit.

Lekë Curri, kryetar fshatit Fushë-Arrëz:

Përsëritje të gjithë pjesëmarrësve dhe falenderime për praninë në këtë dëgjese publike.

Dëgjuam për vlerën e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe realisht jemi të pakënaqur për kjo vlerë është përcaktuar nga qeveria dhe na duhet t'a pranojmë.

Kërkesat tona si fshat janë:

- * Kërkojmë ndriçimin në lagjet Dedaj e Marinaj të fshatit Fushë-Arrëz;**
- * Të ndërhyhet për riparimin e rrugës mbi shtëpinë e Mhill Jakut e cila është duke u shembur;**
- * Të ndërhyhet për riparimin e rrugës poshtë shtëpisë së Tom Currit;**
- * Të sistemohen rendet vaditëse**
- * Të hapen kanalet vaditëse dhe të përdoren tuba në pjesët e vështira në lagjen Gojans;**
- * Të riparohen dhe të bëhen funksionale dritat e rrugës së fshatit Fushë-Arrëz;**

- * Kërkojmë zëvendësimin e koshave të vjetër të mbeturinave me kosha të rinj me kapak në mënyrë që të mos hyjnë qëntë në to dhe të nxjerrin mbeturinat jashtë tyre, ekzistuesit janë të prishur;**
- * Të shtohet sipërfaja e varrezave të fshatit;**
- * Të ngrihet një grup studimor dhe të ndërtohet një projekt për system ngrohje me kaldajë në shtëpitë e banorëve të fshatit.**

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë **z.Hil Curri:**

I nderuar Kryetar i fshatit Fushë-Arrëz, ju falenderojmë që po i sillni kërkesat tuaja të cilat do të jenë prioritetet tona në buxhetin e vitit që vjen.

Projektet e vijave të fshatit janë dërguar për miratim;

Koshat e mbeturinave do të zëvendësohen me të rinj Brenda 3 ditëve, ndërsa koshat e vjetër do të rriparohen;

Vijat vaditëse historikisht janë hapur nga vetë rentarët e vaditjes, por ne ju sigurojmë që do të ndërhyjmë aty ku ka vështirësi për hapje dhe nevojë për tuba.

Mark Gega, kryetar i fshatit Lumardh:

Përhëndetje të gjithë pjesëmarrësve dhe falenderime për praninë në këtë konsultë publike.

Jemi Bashkia me sipërfaqen më të madhe malore në Shqipëri, ndaj kërkojmë:

- Mirëmbajtjen e rrugëve;**
- Të shtohet numri i punonjësve të mirëmbajtjes së rrugëve;**
- Vijat I hapin vetë rentarët, Bashkia të na ndihmojë në hapjen e segmenteve të vështira ose aty ku ka nevojë për ndërhyrje me tuba.**

Më tej z.Mark Gega vlerëson stafin si profesionist dhe uron shëndet, jeni të respektuar!

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë **z.Hil Curri:**

Kemi lobuar me Ambasadën Japoneze e cila na ka premtuar për një mjet të ri për kryerjen e punimeve, dhe mirëmbajtjen e rrugëve, nesër firmosim kontratën

dhe shumë shpejt besoj do të jetë në shërbimin tuaj. Sa për vijat do të bëjmë të pmundurën për t'i hapur ato.

Jetmir Syla, Kryetar i fshatit Micoj:

Përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit që na keni ftuar në këtë konsultë publike.

Si përfaqësues i fshatit Micoj, kërkojmë:

- **Mirëmbajtjen e rrugëve;**
- **Të shtohet numri i punonjësve të mirëmbajtjes së rrugëve;**
- **Vijat i hapin vetë rentarët, Bashkia të na ndihmojë në hapjen e segmenteve të vështira ose aty ku ka nevojë për ndërhyrje me tuba.**

Mikel Qafa, Zv. Kryetari i Bashkisë:

Duke ju falenderuar, ju kujtoj që keni mundësi të sillni propozimet dhe rekomandimet tuaja edhe në faqen web të bashkisë.





SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
NAZE SELIMAJ



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Fushë-Arrëz, më . . . 2024

PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË FUSHË-ARRËZ

Lënda: Përmbledhja e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për programin Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027, Buxhetin e Vitit 2025 si dhe Paketën Fiskale 2025.

PËR:

Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË

KOMISIONIN E EKONOMISË FINANCË-BUXHETIT

KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Lënda: Përmbledhja e rekomandimeve nga dëgjesa publike në Bashkinë Qendër Fushë-Arrëz me datë 14. 11. 2024.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar; Kalendarit të konsultimit publik; Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak; Komisionit të Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare të Këshillit Bashkiak, me datë 14.11.2024 në sallën e Këshillit Bashkiak, u zhvillua konsultimi publik për programin Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027, Buxhetin e Vitit 2025 si dhe paketën fiskale 2025.

Qëllimi i dëgjësës ishte tërheqja e mendimeve, propozimeve dhe kërkesave për Buxhetin e Vitit 2025, kryesisht për Programin Buxhetor 2025-2027.

Grupet që u konsultuan: Banorët e qytetit Fushë-Arrëz si dhe të fshatrave Fushë-Arrëz, Micoj dhe Lumardh; Drejtuesit e institucioneve dhe Përfaqësues nga Shoqëria Civile dhe Biznesi.

Mbështetur në Procesverbalin e dëgjësës publike, mbajtur me datë 14.11.2024, Rekomandimet e dhëna nga banorët e qytetit Fushë-Arrëz si dhe të fshatrave Fushë-Arrëz, Micoj dhe Lumardh; Drejtuesit e institucioneve dhe Përfaqësues nga Shoqëria Civile dhe Biznesi.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim: Gjithsej 53 (27 Femra)

- * Kërkojmë ndriçimin në lagjet Dedaj e Marinaj të fshatit Fushë-Arrëz;**
- * Të ndërhyhet për riparimin e rrugës mbi shtëpinë e Mhill Jakut e cila është duke u shembur;**
- * Të ndërhyhet për riparimin e rrugës poshtë shtëpisë së Tom Currit;**
- * Të sistemohen rendet vaditëse**
- * Të hapen kanalet vaditëse dhe të përdoren tuba në pjesët e vështira në Lagjen Gojans;**
- * Të riparohen dhe të bëhen funksionale dritat e rrugës së fshatit Fushë-Arrëz;**
- * Kërkojmë zëvendësimin e koshave të vjetër të mbeturinave me kosha të rinj me kapak në mënyrë që të mos hyjnë qentë në to dhe të nxjerrin mbeturinat jashtë tyre, ekzistuesit janë të prishur;**
- * Të shtohet sipërfaja e varrezave të fshatit;**
- * Të ngrihet një grup studimor dhe të ndërtohet një projekt për system ngrohje me kaldajë në shtëpitë e banorëve të fshatit.**

Jemi Bashkia me sipërfaqen më të madhe malore në Shqipëri, ndaj kërkojmë:

- *Mirëmbajtjen e rrugëve;**
- *Të shtohet numri i punonjësve të mirëmbajtjes së rrugëve;**
- *Vijat i hapin vetë rentarët, Bashkia të na ndihmojë në hapjen e segmenteve të vështira ose aty ku ka nevojë për ndërhyrje me tuba.**
- *Të shtohet numri i punonjësve të mirëmbajtjes së rrugëve;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Blerim, më 31.10 .2024

PROCES VERBAL I DËGJESËS PUBLIKE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE **BLERIM**

I mbajtur sot, më 31. 10. 2024.

Vendi: Në ambientet e Njesisë Administrative Blerim.

Ora:14:00

Tema: Dëgjese publike ”PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025”.

Në takim morën pjesë nga NjVQV:

1. Kryetari i Bashkisë, z. Hil Curri
2. Zv. Kryetari i Bashkisë, z. Mikel Qafa
3. Kordinatori me BE, z. Elis Miria
4. Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Naze Selimaj
5. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, z. Nikolin Qafa



Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative z.Gjovalin Prendi i cili falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë dëgjese.



- Në emër të banorëve Administratori i drejtohet Kryetarit të Bashkisë **duke vënë theksin në problematikën kryesore që janë rrugët e fshatrave. Është bërë ndërhyrje në rrugët e dy fshatrave Xath**
- **dhe në Sakat, Blerim dhe kërkojmë ndërhyrje edhe në rrugët e tjera me shtrime të pjesshme me çakull, pra nevojitet fadroma dhe kamioni për shtrimin e rrugëve.**
- **Kemi një kërkesë nga fshati Çebik, Trun që ka nevojë për lidhjen e rrugës nga aksi nacional me liqenin e Fierzës i cili bën lidhjen me qytetin e Kukësit për ndihma më të shpejta mjekësore ndaj të sëmurëve.**
- **Kërkojmë të mundësojmë një projekt zhvillimi në vendin e quajtur Boka e Dardhës e cila është favorite për prodhimin e energjisë përmes mullinjve me erë gjithashtu edhe përmes paneleve Diellore.**
- **Kërkojmë ndihmë për rregullimin e kanaleve vaditëse.**
- **Një lagje në Çebik është pa ujë të pishëm, kërkojmë sistemimin e ujësjellësit.**

Më tej **Administratori i Njesisë Administrative z.Gjovalin Prendi** prezanton edhe punët e bëra në këtë Njësi Administrative:

- Është bërë rikonstrukcioni i shkollës Dardhë;
- Është furnizuar me ujë të pishëm shkolla Xath;
- Janë furnizuar me ujë të pishëm godina e Njesisë Administrative dhe shkolla Çebik;
- Janë bërë riparime të urave në Trun të poshtëm që bën të mundur lëvizjen e nxënësve për në shkollë;
- Është bërë pastrami i kanaleve vaditëse që përfshin 3 lagje, Dardhë;
- Kemi blerë gjitha pajisjet dhe orenditë e godinës së Njesisë Administrative.

Duke falenderuar të pranishmit fjalën e merr,

Kryetari i Bashkisë z.Hil Curri:

Sot jam këtu përpara jush në këtë dëgjesë të marr nga ju kërkesat dhe nevojat në mënyrë që të përmbushim programin e buxhetit për vitin 2025.

Unë sot vij përpara jush me kokën lart sepse jam përpjekur të bëj një shpërndarje proporcionale të fondit për katër Njësitë Administrative, Iballë, Fierzë, Blerim dhe Qafë-Mali.

Fondin si Bashki e marrim për numër banorësh por realisht jemi Bashkia me shtrirjen më të madhe gjeografike, kemi 400km rrugë që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin, kemi 5000km rrugë pyjore, kemi 200km vija vaditëse.

Unë si Kryetar Bashkie i besuar nga ju, udhëhiqem nga një parim: Nëse nuk kemi mundësi t'jua zgjidhim të gjitha hallet njerëzve, të paktën mos t'jua shtojmë atyre.

Çdonjëri prej jush është i vlerësuar me të gjitha kapacitetet që ka Bashkia Fushë-Arrëz, ku e drejta juaj nuk do të shkelë kurrë të drejtën e tjetrit.

Kemi Ndërhy me punime për rikonstruksionin e shkollës.

Do të bëjmë edhe sistemimin e varrezave.

Ambasada Japoneze na ka premtu që do të na sjell një mjet të ri për mirëmbajtjen e rrugëve.

Do të bëjmë planin e menaxhimit të Dardhës për pyjet;

UT kamëz do të na ndihmojë me një plan menaxhimi për pjesën e Arst-Miliska deri në Iballë;

Një plan e kemi bërë për Bashkinë Fushë-Arrëz, ku përmes këtyre planeve do bëhet e mundur ardhja e investitorëve;

Po mendojmë të investojmë në instalimin e paneleve Diellore për prodhimin e energjisë, në këtë mënyrë bëjmë të mundur edhe punësimin e njerëzve;

Fshati Flet është i pasur me ujëra të pastër, kjo është mundësi e mirë për investime.

Do të rregullojmë rrugën e Dardhës;

Me VKM që ka dalë për ndërtime në tokën tuaj me një deklaratë që është pronë e juaja është lehtësuar puna shumë.

Shtrimi i rrugëve do të jetë prioritet.;

Shkollat do të mirëmbahen pavarësisht se sa nxënës ka në to;

Do të shfrytëzojmë liqenin e Fierzës;

Aksesimin me fshatrat përmes shtrimit të rrugëve jua premtoj se do e bëjmë;



Projektet do të rrisin numrin e të punësuarve;

Ujësjiellësi është në varësi të Shkodrës por edhe ne do gjejmë mundësi për zgjidhjen e problematikave;

Kemi ndërtuar një program dhe nëse nuk e realizoj pikë për pikë nuk kandidoj më.

Investimet individuale janë shumë të rëndësishme për komunitetin si psh Alfons Uka ka investuar për kanalin vaditës. Do të bashkërendojmë punën me kryeqendrat e fshatrave për adresimin e çdo kërkesë, nevojë për shërbime ndaj banorëve nga ana e Bashkisë.

Faleminderit që më dëgjuat dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj, do t'ju dëgjoj me vëmendje dhe do të shënojmë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime dhe investime publike.

Dash Haxhia, banorë i Njesisë Blerim

Ne jemi mirënjohës nëse ju si Bashkia na vini sadopak në ndimë me shërbimet publike, e kam fjalën për rrugët, ato janë si enët e gjakut që mbajnë zemrën;

Mendoj të kontaktojmë me firmat private për lidhjen e kontratës për pastrimin e rrugëve para se të bie bora;

Shkolla e Trunit në nevojë emergjente për rikonstrukcion, aty nuk ka as dritë ndërkohë ajo shkollë ka numrin më të madh të fëmijëve.

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri

Do bëj çtë munden për përmirësimin e situatës

Vazhdon Dash Haxhia, banorë i Njesisë Blerim

- * Varrezat e Trunit nuk janë rregulluar asnjëherë;
- * Shkolla nuk ka ujë;
- * Rrugët kanë nevojë për pastrim kur bie borë;
- * Kemi një rrugë që shkon dhe bie në breg të liqenit dhe ka nevojë për pastrim, është rrugë ekzistuese. Kanë nevojë për çakull.

Ndërhyn **Administratori i Njesisë Administrative z.Gjovalin Prendi**, depozitën e ujit e gjej unë që sot.



Kryetari I Bashkisë z. Hil Curri

Për të gjitha rrugët egzistuese do të gjejmë padyshim një zgjidhje ndërsa për rrugë të reja duhen procedura më të gjata në kohë.

Kristin Jaku, kryetar I fshatit Çebik



Kërkojmë Riparimin e ujësjellësit, pusetat po shemben, jemi pa ujë, fundja tubin e marr vetë, kërkojmë të na ndihmoni me hapjen e kanalit;

Të mirëmbahet dhe të riparohet rruga deri te Pashk Kola, të mbushet;

Kërkojmë rrethimin e Kishës:

Nëse keni mundësi na ndihmoni në riparimin e linjës energjetike;

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri

Kemi një Biellorus të vogël që do t'a dërgojmë për hapjen e kanalit, gjithçka lidhet me ujësjellësin e ka Shkodra por unë do bëj përpjekje për të sjellë mjetin për hapjen e kanalit të ujësjellësit.

Do të lloboj te OSHE për zgjidhjen e problemeve lidhur me linjën energjetike.

Administratori i Njesisë Administrative z.Gjovalin Prendi

Sa i përket linjës energjetike e lidh unë në shtyllën time e reduktohet problematika deri në zgjidhje.

Zef Nika, banor, Blerim

-Kërkojmë ujë për vaditje

Administratori i Njesisë Administrative z.Gjovalin Prendi



Tubin për ndërtimin pjesërisht të kanalit vaditës e ka sjellë Bashkia, por kur është sjellë tubi ka qënë periudha e vaditjeve dhe prandaj nuk kemi ndërhy. Më saktë për me vendosë tubin kemi probleme me banorët.

Azem Dervishi, Blerim

Unë kam 2 kërkesa – kemi nevojë si zonë për një veterinary

Kemi nevojë si zonë për një Agronom

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri

-Shumë shpejt do të hapet një bankë në Fushë-Arrëz;

-Kam kërkuar një punonjës të zyrës së punës në bashkinë tonë për ta vënë në shërbim të komunitetit;

-Do të punësojmë njerëzit e regjistruar si të papunë;

Njëjtë edhe për Agronomin dhe Veterinerin do të gjejmë një zgjidhje. Kemi një Veteriner nga Mërturi dhe atë mund ta sjellim. Do e gjejmë zgjidhjen me çdo çmim.

Mark Marku, Kryetar i fshatit Dardhë

Kërkojmë riparimin e kanalit vaditës prej 4.5km të gjatë.

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri

Do të bëjmë riparimet me mjet motorrik, ku është e pamundur me fuqi punëtore, me dorë. Në pranverë të gjithë do të vadisin tokat bujqësore.

Muharrem Dervishi, Kryetar i fshatit Blerim

Rrugët në nevojë për riparime dhe mirëmbajtjen e tyre;

Shkolla në Truen pa ngrohje, kërkojmë soba për ngrohje.

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri



Sa i përket rrugëve, duke filluar në Flet e deri në Mëzi nuk do të ketë rrugë të parregulluar.

Ju falenderoj duke ju siguruar se do të mbetemi në kontakt për zgjidhjen e problematikave dhe ofrimin e shërbimeve



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Naze SELIMAJ



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Qafë-Mali, më 19. 11. 2024

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE "PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025" NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QAFË-MALI

I mbajtur sot, më 19. 11. 2024.

Vendi: Në ambientet e Njesisë Administrative Qafë-Mali

Ora:13:00

TEMA: DËGJESË PUBLIKE "PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025".

Në takim morën pjesë nga **NJVQV**:

Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri**;
Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Mikel Qafa**;
Zv. Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Kola**;
Përgjegjësi i Sektorit të Financës, **z. Dritan Lika**;
Kordinatori i projekteve me BE, **z. Elis Miria**
Sekretar i Këshillit Bashkiak, **znj. Naze Selimaj**

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë **banorët e Njesisë Administrative Qafë-Mali (Kryezi; Qafë-Mali; Orosh; Armiraj; Lumbardh; Lajthizë; Tuç; Srriqe; Mollë Kuqe) si dhe kryetarë të fshatrave.**

Fjalën hapëse e mban Zëvendëskryetari i Bashkisë, **z. Hil Kola**:

Përsëritet të gjithëve dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjese publike.

Bashkia Fushë-Arrëz po bën mbledhjen e rekomandimeve nga ana e banorëve përmes dëgjesave publike në mënyrë që këto rekomandime të pasqyrohen në buxhetin e vitit 2025.

Paraprakisht po sqarojmë lidhur me arritjet e buxhetit të vitit 2024:

Në Qafë-Mali për 2024 ka pasë shumë kërkesa. Ne kemi bashkërenduar punën sëbashku me Këshillin e Bashkisë dhe kemi bërë një shpërndarje proporcionale në të gjitha njësitë Administrative me nga 40 milion lekë të vjetra për secilën Njësi Administrative. Investimet e planifikuara për Njesisë Qafë-Mali për vitin 2024, janë realizuar përafërsisht në masën 80% për arsye objektive.

Disa investime nuk janë bërë për mungesë fondesh. Ka qenë një investim i parasikuar në lagjen Aliaj, Kryezi që për mungesë fondesh nuk është realizuar. Përfaqësuesit e kësaj lagje, përsëri kanë sjellë kërkesë me shkrim të cilën do t'ja dorëzoj Kryetarit të Bashkisë.

Sa i përket zonave si Orosh, Kryezi do i marr me radhë. Po ju shpjegoj që në vitin 2024 janë bërë investime që kanë qënë parashikuar qysh në vitin 2023 dhe nuk kanë qenë përfunduar, pra i kemi përfunduar mbasi kemi ardhjes tonë në krye të Bashkisë nga Maji i vitit 2023. Po ju bëj me dije se kur kemi ardhë Ne në krye të Bashkisë kemi gjetë me dokumentacion investime në zona të ndryshme të cilat nuk janë kryer realisht. Kështu që ligjshmërisht në ato zona nuk na lejohet ndërhyrja para 5 viteve. Edhe mbas 5 vjetëve ligjshmërisht mund të bëhet vetëm riparim sepse ndërhyrje totale lejohet vetëm mbas 8 vjetësh.

Kërkesat kryesore të banorëve të Njesisë Administrative Qafë-mali janë për Jazet, ujësjellësat, për vijat vaditëse. Ndërsa riparime e pastrim rrugësh, sistemim varrezash, janë kryer plotësisht nga Njësia Administrative.

Buxheti këtij viti nuk na favorizon për ndërhyrje të mëdha, vetëm nëse na mundëson Qeveria qendrore, sepse buxheti për vitin 2025 është pothuajse sa ai i vitit të kaluar dhe kërkesat janë shumë më të shumta.

Vendimet e gjykatave që kanë dalë këtë vit dhe ato të vitëve të mëparshme që kanë qenë të pazbatuara nga Qeverisja vendore e mëparshme i kanë sjellë një dëm ekonomik rreth 600 milion lekë të vjetra Bashkisë Fushë-Arrëz. Ju bëj thirrje banorëve që të paguajnë detyrimet si taksat.

Kryetarët e fshatrave paguhen nga Bashkia prandaj të jenë më të përgjegjshëm dhe të sjellin në kohë problematikat aty ku janë emergjente. Kërkojmë bashkëpunim maksimal.

Uroj të na mirëkuptoni për gjithçka, ne do të përpiqemi maksimalisht Brenda kapaciteteve tona të bëjmë kërkesat e rekomandimet tuaja pjesë e buxhetit për vitin 2025. Duke ju falenderuar, fjalën për sqarime më të hollësishme lidhur me buxhetin e po e kaloj te Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri.

Kryetari i Bashkisë **z. Hil Curri:**

Përhëndetje të gjithëve dhe mirë se keni ardhë!

Dëgjesat publike janë të detyrueshme për mbledhjen e rekomandimeve referuar nevojave dhe vizionit tuaj për një zhvillim të qëndrueshëm.

Njësia Administrative Qafë Mali është pak më e privilegjuar për faktin se në territorin e saj gjenden dy nga fabrikat e ujit të pishëm dhe fabrika pasurimit të

bakrit. E theksoj se për çdo objekt që ndërtohet në territorin tuaj duhet të bëhen dëgjesa publike dhe ju duhet të bëheni pjesë e konsultës në mënyrë që të mos keni pretendime më pas, por gjithçka të jetë e konsultuar më parë.

Shembulli më pozitiv është fabrika e ujit Lajthiza e cila ka ardhë në ndihmë të zhvillimit të zonës. Zhvillimi i zonës tonë është një process kompleks. Kemi bërë një plan menaxhimi dhe këtu gjej rastin të falenderoj si kryetarët e fshatrave ashtu edhe Këshillin Bashkiak i cili ka qenë promotor për zhvillimin e zonës.

Ka 30 vjet që Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka pasë një plan menaxhimi. Ne e kemi bërë Planin e menaxhimit dhe është konfirmuar. Planin e parë e kemi filluar prej te ura e Bardhetit deri në kufi me Njësinë Administrative Qafë-Mali. Planin e dytë e kemi për njësinë Administrative Blerim. Planin e tretë me ndihmën e UT të Kamzës e kemi në Njësinë Administrative Iballe plus Fierzë dhe planin e katërt do t'a bëjmë nga fleti në Lajthizë e deri në Xath.

Në bazë të studimeve që janë kryer, këto zona janë favorite për për investime në fushën energjetike për vendosjen e paneleve diellore dhe mullinjve të erës. Janë bërë matj dhe presim nga dita në ditë të fillojnë punimet. Instalimi i paneleve diellore është i rëndësishëm sepse 5% e fitimit shkon në favor të komunitetit. Lutem banorëve që do t'ju përkasin në tokat e tyre të jenë bashkëpunues. Sa i përket ujit të pishëm në sajë të analizave që janë bërë ka rezultuar I pastër.

Unë si Kryetar Bashkie kam dalë nga një forcë politike, por që nga dita e parë në qeverisjen vendore jam Kryetari në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim krahu politik. E rëndësishme është se kemi gjetë gjuhën e komunikimit dhe kemi bashkëpunim me Qeverisjen Qendrore.

Njësia Administrative shtrihet në një sipërfaqe shumë të madhe dhe ne nuk mund të lëmë asnjë territory mbas dore, dhe do t'i shohim me prioritet.

Ujësjiellësi e ka selinë drejtuese në Shkodër dhe kemi vënë re se nuk përgjigjet për shërbimet e kërkuara që janë nevojë, domosdoshmëri e mbi të gjitha detyre e tyre. Ndërsa ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë për shërbime në këtë sektor. E mira do të ishte që Ndërmarrjen e UKFA t'a kishte Bashkia në menaxhim në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimin e duhur.

Fshatrat kanë shumë nevojë për shërbime lidhur me ujësjiellësin. Ne si bashki do të përpiqemi përmes donatorëve të ju afrojmë shërbim familjeve dhe banorëve edhe pse nuk është detyrë e jona lidhur me ujësjiellësin.

Ujësjiellës-kanalizime në Fushë-Arrëz duhet të vendosë matësit në çdo shtëpi e kështu edhe banorët ndërgjegjësohen të mos e shpërdorjnë ujin e pishëm vend e pa vend.

Problematika kryesore e fshatrave sot është se kanë ikë familjet dhe rentarët e paktë të vaditjes vaditjeve që kanë mbetë nuk mund të hapin gjithë atë gjatësi kanali. Ama gjithmonë vijat e zakonit janë hapur nga vetë rentarët.

Bashkia Fushë-Arrëz ka rreth 200 km vija vaditëse, ne do të vemë punonjësit dhe kapacitetet tona në dispozicion dhe të ndihmojmë banorët aty ku segmentet janë më të vështira.

Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve kemi firmosur me Ambasadën Japoneze për një mjet të ri i cili do të vihet në shërbim menjëherë.

Rruga e Lajthizës do të riparohet nga përgjegjësit e fabrikës së ujit.

Kemi rritë numrin e të punësuarve por ka nevojë përsëri, kjo mbetet prioritet për ne.

Do të lloboj fortësisht për të siguruar një mjet për hapjen e vijave vaditëse.

Jam optimist dhe do të punoj pa rezerva në shërbim të qytetarëve.

Faleminderit për vëmendjen tuaj , unë jam i hapur dhe i gatshëm të marr rekomandimet tuaja në mënyrë që ato të bëhen prioriteti ynë në buxhetin e vitit 2025.

Ylber Voci: Banor në Kryezi

- **Kemi nevojë për rregullimin e 500 metrave kanal vaditës, nuk po mundemi të bëjmë asnjë prodhim bujqësor.**

Drilon Murati: banor

- **Kërkojmë ndihmën e bashkisë për hapjen e vijave të ujit vaditës sepse kanë ikur familjet dhe ne e kemi të pamundur të i hapim vetë.**

Besim Arifaj, banor i lagjes Arifaj, fshati Kryezi.

Problemi qëndron tek uji i pishëm, ku ne paguajmë për këtë ujë dhe nuk kemi shërbime, 200 m tub i kemi blerë vetë.

Kërkojmë shërbim për ujësjellësin.

Sahati i ujit është rreth 700-800 metër larg shtëpisë. Faturat vijnë me kosto të lartë për tu paguar, prandaj nuk jemi dakort dhe dyshojmë për ndërhyrje në sahat.

Të shtrohet rruga me çakull, pasi po bëhët çdo ditë e më e pakalueshme dhe nuk ka pasur asnjë lloj ndërhyrje.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë :

Ujësjiellësi nuk është në varësinë tonë. Kur kemi marrë mandatin ne e kemi gjetur vendimin e këshillit për kalimin e ujësjiellësit në Shkodër. Ndërsa për rrugën kemi planifikuar ndërhyrje për pastrim dhe shtrim me çakull.

Agim Pashkaj: Jam kryetari i fshatit Lajthizë dhe unë në emër të gjithë banorëve të falenderoj ty z. kryetar për punën e palodhur që po bën. Fshati jonë nuk ka asnjë problem për të paraqitur, pasi ujë, rrugë dhe drita kemi, banorët janë të punësuar të gjithë tek fabrika e ujit dhe jemi në rregull me çdo gjë.

Ndrek Çuku: Jam kryetari i fshatit Kryezi. Problem kryesor në fshatin tonë mbetet problemi i ujit të pijshëm, disa janë me sahata dhe disa të tjerë jo. Ose të bëhen të gjithë me sahatë ose asnjë, kemi bërë dy herë kërkesë dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Gjithashtu **kërkojmë disa tuba për ujin vaditës.**

Kryetari i Bashkisë Z.Hil Curri:

Për ujin e pijshëm ne e shpjeguam disa herë që nuk është kompetencë e jona, tubat për ujin vaditës do i sjellim vetëm mjafton që ju të na i matni dhe të na tregoni fiks sa metër tub duhen. Edhe për pastrimin dhe sistemimin e çdo rruge do bëjme maksimumin tonë.

Gjovalin Prenga: Kryetari i fshatit Qafë-Mali.

Kërkoj ndërhyrje ne rrugën që lidh Bardhetin me Qafën e Barit, Lakun e Roshit dhe Lumbardhin, kjo rrugë është dëmtuar si pasojë e kalimit të mjeteve me tonazh të lartë.

Gjithashtu kemi rrugët e lagjeve Palucaj, Vasijaj dhe Tuç që kanë nevojë për pastrim.

Kërkojmë që për tek varrezat e Lagjes Bardhet të bëhet një strehë, ku vendoset i vdekuri për të kryer homazhet.

Kryetari I Bashkisë Z.Hil Curri:

Për rrugën do të bëjmë projektin dhe shumë shpejt do të këtë ndërhyrje. Rrugët e lagjeve që ti listove do ti pastrojmë të gjitha.

Zef Lleshi: Kryetari i fshatit Lumbardh.

Kërkoj që të bëhet rruga e Tuçit dhe Lumbardhit, si dhe të pastrohen rrugët që të dërgojnë tek varrezat.

Kërkojmë që rruga e Lumbardhit të ketë punëtor mirëmbajtës.

Pashuk Bibaj: Kryetari i fshatit Orosh:

Kërkoj që të merret parasysh nga ana juaj, një rrugë malore shumë e madhe ku ka nevojë për ndërhyrje, pasi në ditët me shi dhe me dëborë ka shumë vështirësi deri në pamundësi në lëvizje.

Kryetari i Bashkisë Z.Hil Curri:

Ne marrim parasysh çdo gjë që ju na kërkon, kemi një staf të tërë këtu që po shënon çdo gjë që ju kërkon, prandaj shpresoj që rrugën në fshatin Orosh ta rregullojmë sa më shpejt, pasi me të vërtetë është problematike dhe për sa i përket kërkesave që bëri kryetari i fshatit Lumbardh do të bëjmë të pamundurën për zgjidhjen e këtij problemi.

Ju falenderoj të gjithëve për praninë tuaj në këtë takim dhe ju siguroj zgjidhjen e problematikave dhe ofrimin e shërbimeve!

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Naze Selimaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Fierzë, më 31.10 .2024

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FIERZË

I mbajtur sot, më 31. 10. 2024.

Vendi: Në oborrin e Njesisë Administrative Fierzë.

Ora:10:00

Tema: Dëgjesë publike ”PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 DHE PAKETA FISKALE 2025”.

Në takim morën pjesë nga NjVQV:

- 1. Kryetari i Bashkisë, z. Hil Curri**
- 2. Zv. Kryetari i Bashkisë, z. Mikel Qafa**
- 3. Kordinatori me BE, z. Elis Miria**
- 4. Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Naze Selimaj**
- 5. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, z. Nikolin Qafa**



Fjalën hapëse e mbajti **Administratori i Njesisë Administrative z. Ylber Sokoli**



Ju falenderoi të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Hil Curri për dëgjesën publike të organizuar si asnjëherë më parë me banorët e zonës, paçi faqen e bardhë!

Administratori i Njesisë Administrative z. Ylber Sokoli e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave që kanë banorët e Njesisë Administrative Fierzë.

Z. Ylber Sokoli rendit disa punë të kryera në zonën e Fierzës përmes investimeve nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz nën drejtimin e Kryebashkiakut Hil Curri:

- * Janë investuar 2 km kanal vaditës prej në Maknre e deri te puset, falë përkushtimit të Kryetarit të Bashkisë z. Hil Curri;
- * Është ndërtuar ura që lidh fshatin Buxhon-Kokdodë dhe për këtë falenderojmë njëkohësisht investitorin e kësaj ure z. Filip Gjoka;
- * Është bërë e mundur lidhja e fshatrave Bugjon – Gralisht përmes ndërtimit të urës me të ardhurat e bashkisë;
- * Është ndërtuar ura që lidh fshatin Aprripë me qendrën e Njesisë Administrative Fierzë;
- * Është ndërtuar tualeti i shkollës në fshatin Porav, shkollë kjo ku qysh nga viti 1990 nuk ka funksionur tualeti as për nxënësit dhe as për mësuesit e kësaj shkolle;
- * Është rikonstruktuar rruga Bugjon – Urë Drini me makineri të rënda;
- * Është bërë pastrami dy herë i rrugës Kokdodë, Aprripë, Mertur;

Z. Ylber Sokoli u shpreh se nuk do të ndalojmë në shërbimet dhe investimet publike falë mbështetjes e bashkëpunimit me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Kryetarin e saj z. Hil Curri.

Në vijim fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë, z. Hil Curri:**



Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjese konsultative ku pjesëmarrja juaj tregon se interesi qytetar dhe padyshim besimi ndaj pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Dëgjesat publike si kjo janë të rëndësishme për një qeverisje pranë qytetarëve. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime publike në mënyrë që të ndërtojmë një buxhet sa më afër realitetit.

Realisht jemi përball një realiteti i cili kërkon investime të mëdha, përpos kësaj jam optimist se do të kemi arritje të kënaqshme. Padyshim që çdo kërkesë e juaja është marrë parasysh dhe është pasqyruar me investimet që Administratori listoi më parë dhe nuk po i përsëris.

Banorët kanë pritshmëri të mëdha dhe ju e dini që unë kam bërë përpjekje maksimale dhe do të vazhdoj t'a bëj për me gjetë çdo lloj mundësie për t'iu ardhur në ndihmë banorëve të zonës si për realizimin e nevojave që janë kompetencë e Bashkisë, ashtu edhe për nevojat që nuk janë kompetencë e Bashkisë, besoj fortësisht se nuk do t'iu zhgënjëj.

Problematikat në këtë zonë nuk kanë ardhur për një vit, shkolla në Porav ishte lënë pa banjo për shumë vite me radhë, tani është ndërtuar.

Klima e investimeve është shumë e mirë dhe në bashkëpunim me fshatrat do t'ia dalim. Këtu gjej rastin të falenderoj biznesmenin, z. Filip Gjoka për kontributin që ka dhënë në ndërtimin e urës që lidh fshatin Buxhon-Kokdodë në vendlindjen e tij.

Jemi në bisedime me biznesmenë dhe emigrantët dhe ju bëj me dije se do të kemi investime të shumta. Besoj në mbulimin energjetik të zonës me panele Diellore.

Dua të falenderoj Alfons Uka në Fierzë i cili ka premtuar të investojë me financat e Tij sjelljen e ujit të pishëm për shkollën, qendrën shëndetësore dhe kishën.

Kemi dërguar kontenier për t'i përshtatur si shkollë në Berishë të Epërme.

Është bërë projekti i rrugës për tu lidhur me Aprripën e Gurit.

Kemi lobuar me Ambasadën Japoneze e cila na ka premtuar për një mjet të ri për kryerjen e punimeve. Ne do të lobojmë të mbajmë këtu banorët dhe gjithashtu për kthimin e banorëve duke ju krijuar kushte normale të jetesës.

I kam bërë me dije edhe Kryeministrit Edi Rama që ne jemi Bashki që japim më shumë sesa marrim. Fondin e Bashkisë jam përpjekur t'a ndaj në mënyrë proporcionale në të gjitha Njësitë Administrative. Kemi punësuar banorë por ka nevojë për më shumë.

Kryeplehtë janë të detyruar ligjshmërisht të bëjnë detyrën lidhur me të gjitha nevojat e punët në komunitet veçanërisht për problematikat dhe nevojat emergjente, në bashkëpunim me Ne, disa situata të jashtëzakonshme i zgjidhim edhe privatisht me miqtë dhe shokët që janë të gatshëm me kontribu pa prituri kur çëlet fondi i Bashkisë.

Djemtë e kësaj zone që kanë emigruar mbas 2 takimeve që kemi bërë bashkë janë shprehur të gatshëm të kthejnë sytë nga vendlindja dhe të bëjnë diçka për vendin e tyre, jam i gatshëm t'ju bashkohem edhe unë privatisht me një rrogë nga xhepi im dhe t'i ndihmojmë me ç'të mundemi institucionalisht.

Ne po synojmë që çdo i ri apo e re që është këtu të punësohet e t'i krijohen kushtet normale për jetesë në mënyrë që të ndalojmë sadopak fenomenin e largimit nga vendlindja.

Ne sot jemi këtu të dëgjojmë nevojat dhe kërkesat tuaja ku asgjë nuk është e përealizueshme në mënyrë që të ndërtojmë një program të kompletuar për buxhetin afatmesëm 2025-2027, buxhetin e vitit 2025 si dhe për paketën fiskale 2025 të cilit do t'i hapet drita jeshile për t'u kthyer në vendim në këshillin e bashkisë.

Nuk kam bërë dhe nuk do të bëj asnjë hap pas duke biseduar dhe bashkëpunuar me të gjithë faktorët politik dhe jopolitik, me të gjitha fondacionet, Ambasadat në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve si dhe zhvillimin afatgjatë të territorit të bashkisë tonë. Zhvillimi do të jetë shumë i shpejtë. Besoj se çdo ditë e më shumë banorët do të mendojnë se kanë pasë të drejtë që më kanë votuar.

Faleminderit që më dëgjuat dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj, do t'ju dëgjoj me vëmendje dhe do të shënojmë çdo kërkesë dhe nevojë tuajën për shërbime dhe investime.

Fjalën e merr banori **Bardhok Dednika** :



Votën nuk t'a kam dhënë Hil Curri por të falenderoj shumë për ndërtimin e kanalit vaditës të fshatit Fierzë me tuba.

Faleminderit edhe Administratorit Ylber Sokoli. Këtë kontribut për Fierzën nuk e ka bërë askush tjetër përveç teje z. Hil Curri, singerisht bravo, të lumshin duart!

Palush Gjoni, Kryetar i fshatit Fierzë:



Falenderoj Kryetarin e Bashkisë z. Hil Curri si dhe Administratorin e Njesisë Administrative z.Ylber Sokoli për korrektesën në orar, keni ardhë një minutë para njoftimit, bravo!

I nderuar Kryetar jam plotësisht dakord kur thua:

- Ndryshimi kërkon fonde të mëdha;
- Nuk do t'a kthejmë kokën mbrapa, do ecim vetëm përpara, nga e kaluara do mbartim vetëm të mirat;
- Kemi bërë dy takime productive në Fierzë;
- Do të bëj rrugën e Fierzës;
- E kam nisë me shpirt e zemër dhe uroj t'ia dalim së bashku;
- Administratori na e ka lehtësuar punën;
- Kompromis me të padrejtën nuk bëjmë kurrë;
- Jemi entuziast, po bëhen kanale vaditëse, rrugë, ura etj;
- Plantacioni energjetik u realizoftë;
- Do të krijojmë lidhje me donatorë për kontribute dhe investime në nevojë të banorëve;
- Kemi perspektivë për turizëm;
- Shkollat do të jenë funksionale;
- Nuk jam i njëanshëm, po punoj me të gjitha kapacitetet e mundësitë;
- Nuk pranoj të them jam i varfër.

Të ectë mbarë!

Vazhdon **Palush Gjoni**, bravo Kryetar! Na e rrenqethe trupin kur the që do ndërtoj shkollën, ne të falenderojmë!

Si Kryetar fshati jam tërësisht i paimplikuar në punë të paligjshme dhe **kërkoj të sistemohen vadat e banorëve. Qendra publike** është përfol, uroj të bëhet.

Kryetar ke shtruar rrugën e punës, vota shkon te i zoti. Të ectë mbarë!

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri:



Kam 12 muaj që lloboj për hapjen e një banke në qytetin Fushë-Arrëz dhe besoj që shumë shpejt do të jetë në shërbim të të gjithë banorëve të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Banka do të ofroj shërbime deri në shtëpi për njerëzit në nevojë.

Kështu banorët do të kursejnë shpenzime të panevojshme duke u sorollatur për të gjetë një bankë për shërbime të domosdoshme ndaj tyre.

Sa i përket politikës unë jam me Mbretin, jam për zgjidhje të shpejta dhe pa dallim krahu politik, para meje janë të gjithë të respektuar.

“Burri më i vogël në botë është ai që ka një post dhe e shfrytëzon atë”.

Gjokë Faslia, Kryetar i fshatit Porav:



Unë si Kryetar i fshatit Porav po flas në emër të banorëve dhe kemi këto **kërkesa**:

- Kemi 7 km rrugë në Porav që kurrë nuk është vënë dorë në to, ju lutem bëni diçka;
- Shkolla në Porav po shembet dita - ditës, nxënësit janë në rrezik për jetën, ju lutem pranoni kërkesën tonë për ndërhyrje;
- Kërkojmë përmirësimin dhe mirëmbajtjen e pyjeve;
- Kemi 13 nxënës që bëjnë çdo ditë 5 km rrugë në këmbë. Kërkojmë të vihet një furgon për transportin e tyre. Këtë ia kërkojmë arsimit.

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri:

Për nxënësit e shkollës së mesme besoj do të gjejmë një zgjidhje, besoj do të bëhet shumë shpejt i mundur transporti.

Musë Prela, banor, Fierzë :



Kërkojmë asfaltimin prej 3 km rrugë në qendër të njesisë Administrative Fierzë, lutem kërkesën tonë përcillen deri te Kryeministri Edi Rama. Nuk ka në Shqipëri qendër Njësie të pa asfaltuar përveçse te ne në Fierzë.

Kanalin vaditës e ke ba, bravo Kryetar! Paç faqen e bardhë Kryetar që keni ardhë në këtë dëgjese bashkë me ekipin tënd!

Kol Shpendi, Kryetar i Fshatit Aprripë:

Unë si përfaqësues i Aprripë Guri kam dy kërkesa;

1. Shkolla në Aprripë nuk ka ujë, ndriçim as tualet, ju lutem na ndihmoni!
2. Kërkojmë pastrimin e 2km rrugë në Aprripë.

U ba rruga Fierzë – Aprripë dhe kjo ishte me kryesorja.

Administratori i Njesisë Administrative z. Ylber Sokoli :

Jo më larg se dje e kemi biseduar me Kryetarin që ujë e drita shkollës Apripë do i vijjnë Brenda muajit Nëntor.

Ded Elezi, banorë i Njesisë:

Falenderoj Kryetarin dhe ekipin që erdhët për këtë dëgjesë.

Jam plotësisht dakord me diskutimin e kryeplakut të fshatit Fierzë. Unë si plak i fshatit Kokdodë kam 2 kërkesa të bashkëfshatarëve të mi:

1. Ne kemi pasë përherë kashnjat gështenjash. Ka rënë një sëmundje e grerëzës së gështenjës e cila ka ulë prodhimtarinë dhe po krijon tharje. Mendohet se është një krimb i hedhur. Kërkojmë ndërhyrje nga ana juaj Kryetar që të luftohet kjo sëmundje përmes dezinfektimit. Kjo pasuri na ka ngelur, ndaj mos ta humbasim.
2. Shtyllat e transportit të energjisë elektrike janë të viteve '70, është amortizuar gjithçka, sa bie një shi kemi probleme dritat dhe detyrohemi vetë të ngjitemi në shtylla për të lidhë telat duke rrezikuar edhe jetën kështu. Nëse mundeni të e transmetoni këtë problematikë tek përfaqësuesit e OSHE-së edhe ju si Bashki sa të mundeni.

Faleminderit të gjithëve juve që keni ardhë nga Bashkia për të na dëgjuar kërkesat dhe nevojat tona, realizimi brenda mundësive.

Frederik Hysa, banorë

Ju përshëndes dhe ju falenderoj për dëgjesën publike që po bëni sot këtu.

Puna që ju po bëni Kryetar është e dukshme, ka një ndryshim pozitiv nga ana e pushtetit vendor, u përmendën më parë investimet që janë bërë më iniciativën e Kryetarit dhe stafit të Bashkisë. Një falenderim kam edhe për drejtuesin e Njesisë Administrative Fierzë z. Ylber Sokoli për punën e përkushtimin.

- Në lidhje me pyjet i bashkohem shqetësimit që ngriti Ded Elezi. Ne kemi një kashnjat gështenjash dhe përveç sëmundjes së kancerit të gështenjës është përhap edhe një grerëz Aziatike që po bën një dëm të paparë, dhe ky është një problem shumë shqetësues, ndaj kërkojmë ndërhyrje nga ana juaj kryetar.
- Problemi i rrugëve: falenderojmë shumë për përkujdesin që ka treguar bashkia në lidhje me rrugën e Bugjonit, vërtet është një vend që rrëshqet por ju keni bërë që ajo rrugë të jetë funksionale, neve na shërben kjo rrugë si fshat Bugjoni që lidhet edhe me Fierzën, me Berishën, me Merturin edhe me zonën e Iballës. Falenderoj Kryetarin për punën e mirë që ka bërë deri tani si vizionar, është i drejtë dhe nuk anon nga interesi personal. Të gjithë investitorët që kanë dashur të kontribuojnë, te Kryetari e kanë gjetur derën të hapur. Ju falenderoj nga zemra!
- Unë banjo këtu dhe kemi problemin e vadës së Gralishtit, nëse mundeni futeni në buxhetin e 2025.

Kryetari i Bashkisë z. Hil Curri:

Sa i përket kanaleve vaditëse absolutisht do ti hapim në kohë, do të bashkëpunojmë me kryepleqtë dhe do gjejmë donatorë përveç investimit nga Bashkia duke bërë të mundur në pranverën që vjen, vaditje të arave.

Sa i përket gështenjave kemi lobuar me UT e Kamzës dhe do të sjellim një laborator që do të na ndihmojë në këtë fushë dhe për më tepër një fond që vjen më i pari do të shkojë për kashnjetin e gështenjave.

Ishte kënaqësi, do takohemi përsëri, jam i hapur ndaj çdonjërit!



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Naze SELIMAJ

